



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:237879

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05845314

Ac.nr.8150/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Nora Bllaca Dula e Halide Reka, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. M nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. A avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse, duke vendosur lidhur ankesën e të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.2273/2021 të datës 31.10.2022, me datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.2273/2021 i datës 31.10.2022, dhe gjykohet: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses A. M nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit i shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse t'ia paguaj, shumën e përgjithshme 2,116.98 €.

Secila palë i heq shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, miratohet kërkesëpadia e paditëses A. M, nga Prizreni. Detyrohet e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në emër të kompensimit i shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse paditëses A. M, shumën e përgjithshme 2,116.98 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Detyrohet e paditura Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditëses ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 134,00 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditëses, apo i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja A. M ka parashtruar padi ndaj të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses, në emër të kompensimit i shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse t'ia paguaj shumën e përgjithshme 2,116.98€.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar me ankesë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Siç del nga shkresat e lëndës, paditësja pretendon se e drejta e tij buron nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive e datës 01.01.2015, ndërsa gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke e detyruar të paditurën si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar me ankesë. Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se një qëndrim i tillë juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, në mënyrë të gabuar është zbatuar e drejta materiale. Kolegji gjenë se paditësja të drejtën e saj e ka mbështetur në Kontratën e Përgjithshme Kolektive e datës 01.01.2015 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 01.01.2018. Kolegji vlerëson se kjo kontratë në rastin konkret nuk mund të zbatohet, për faktin se paditësja padinë e ka ushtruar me datë 24.08.2018, ndërsa është pensionuar me datë 27.05.2018, që i bie pas afatit të skadimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, të cekur më lartë.

Në nenin 201 par. 1 është përcaktuar se: *“Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes kryesore drejtpërsëdrejti, me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, po që se konstaton se ekziston ndonjëri nga këto shkaqe të treguara në ankesë: d)... nëse konsideron se gjendja faktike e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar drejte, por e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë”.*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kolegji e ka bazuar në nenin 465 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika e) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8150/2022 me datë 18.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj